



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br. 267/20  
Nr. i fq. / Br. sh. - 8 -  
Data: / Datum 30. 12. 2020

VUŠITRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJA E JASHTËZAKONSHME E KUVENDIT TË KOMUNËS SË**  
**VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 7 DHJETOR 2020**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtrri, duke filluar në orën 10:20.*

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrris:

Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Arta Ymeri, Basri Menxhiqi, Bahrije Ademi Murati, Fatmire Saraçi, Selim Rrustemi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Faton Shabani, Fitim Halili, Gresa Muli, Gentiana Rama, Habibe Gërxhaliu, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Miljan Bojković, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Ismet Hajrizi, Ilir Krasniqi, Melihate Basholli-Latifi, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Nurtene Çerkezi-Gyshinca, Sajdie Bajgora, Suzana Sylja Teuta Aruçi Shartari Shpëtim Zhegrova dhe Ymer Haradinaj.

**Munguan:**, Ali Januzi, Hysni Gërguri dhe Shkëlzen Feka.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë prezent 32 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z.Xhafer Tahiri nënkryetari i komunës z. Besim Muzaqi, drejtor të drejtorive komunale dhe zyrtarë tjerë kompetent komunal.

**Nasuf Aliu, kryesues i Kuvendit-** pasi hapi mbledhjen tha se uroj që të tejkalohet kriza nga pandemia që e ka përfshirë globin në tërësi. I cili prezantoi rendin e ditës para anëtarëve të kuvendit.

**Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë me vota “unanime” aprovoi këtë**

**R E N D I T E**

1. Përkrahja financiare për të infektuarit me COVID-19 në Komunën e Vushtrrisë.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-**prezantoi iniciativën e marrë nga anëtarë i kuvendit z.Lorik Maxhuni, dhe të përkrahur nga grupi kuvendar i PDK-së për ofrimin e përkrahjes financiare për të infektuarit nga COVID – 19 në Komunën e Vushtrrisë. Rrjedhimisht përkrahja ka konsistuar në

mbledhjen e nënshkrimeve nga anëtarët e grupit kuvenda të PDK-së për thirrjen e mbledhjes së jashtëzakonshme dhe 12 nënshkrimet e këtij grupi apo 1/3 e anëtarëve të kuvendit konform legjislacionit në fuqi është thirrur kjo mbledhje, me të vetmen pikë të rendit të ditës Propozim-vendim Përkrahja financiare për të infektuarit me COVID-19 në Komunën e Vushtrrisë. Andaj propozojnë dhe i ftojnë edhe grupet tjera kuvendare ta mbështesin këtë propozim ashtu që tu dilet në ndihmë financiare të infektuarëve me Covid-19, përmes pagesë direkte në xhirollogarinë bankare. Propozim për përkrahje financiare konsiston në përkrahje të personave apo familjet e prekura me covid-19 të cilët janë të evidentuar në listën e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, listë kjo të cilën komuna e ka pranuar çdo ditë dhe beson se është azhurnuar në data-bazën e komunës, nga marsi kur është regjistruar rasti i parë në Komunën e Vushtrrisë e deri më sot. Propozimi për përkrahje financiare është me sa vijon:

1. Me nga 150 € të përkrahen të gjithë të prekurit me Covid-19 të cilët janë nën moshën 65 vjeçare;
2. Me nga 250 € të përkrahen të gjithë të prekurit me Covid-19 të cilët janë mbi moshën 65 vjeçare;
3. Me nga 350 € përkrahen të gjithë familjet e të prekurve me Covid-19 të cilët nuk kanë mundur ti mbijetojnë kësaj pandemie. Me këtë vendim me të gjitha propozimet e cekur, saktësojë se të drejtë aplikimi për këto shuma kanë të gjithë ata që janë të regjistruar në IKSHPK, dhe kërkoj që komuna të krijoj kushte që aplikimi të bëhet online. Pakoj financiare e këtij vendimi nuk mund të definohet saktë pasi që fatkeqësisht pandemia është duke vazhduar dhe kemi çdo ditë numra të ri të të infektuarëve dhe kërkoj nga qeveria komunale që të votoj mjete të mjaftueshme në mënyrë që pa vonesa të filloj pagesa dhe transferi i mjeteve të propozuara. Paraprakisht grupi kuvendar i PDK-së i ka analizuar kapacitetet financiare të komunës dhe ka nxjerr konkluzionit se kemi mjete të mjaftueshme në buxhet për mbulimin e kostos financiare të këtij vendimi, si tek kategoria e mallrave dhe shpenzimeve fondi 21 dhe 22 e që afati për zotimin e mjeteve është deri me datën 24 dhjetor 2020. Po ashtu mjete të mjaftueshme ka edhe tek kategoria e subvencioneve, por që propozimi i tij ishte që me këtë vendim të autorizohet kryetari i komunës që ai të vendos se nga cili fond do ti marr mjetet për mbulimin e këtyre shpenzimeve. Në fund i ftoj të gjitha grupet kuvendare që ta përkrahin këtë propozim dhe të tregojmë se kuvendi është ai i cili vendos për përkrahje dhe për drejtimin e buxhetit pa pasur ndikime as nga qeveria e as nga kryetari i komunës, kjo përkrahje sa do pak do ta zbutet krizën që i ka pllakosur familjet tona, ndërsa për familjet që kanë humbur të afërmit e tyre do të ishte një satisfaksion moral dhe institucional i institucioneve të shtetit.

**Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit**-tha se i vjen mirë që qeverisja dhe bashkëqeverisja, ka filluar që edhe tjerët ti bëjë socialdemokrat. Tutje shtoi se propozimi është i mirë por duhet të shikohen mundësit që i ka komuna. Andaj në emër grupit kuvendar të LVV-së propozoi që personat deri në moshën 65 vjeçare që janë prekur me covid-19 ti marrin nga 50 €, personat mbi moshën 65 vjeçare ti marrin nga 100 €, ndërsa familjet që kanë humbur anëtarët e familjes ti iu ndajmë nga 200 €.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit, vlerësoi se menaxhimi i komunës në këta muaj të pandemisë, ka qenë një ndër detyrat më të rënda për të dhe për qeverinë komunale. Nuk ka pasur dhe nuk do të ketë vendim më të rënd për të si kryetar komune se sa vendimi për ta mbyllur qytetin, nuk do të ketë kurrë vendim më të rënd se sa ta detyrosh një familje të izolohet edhe pse ndoshta vetëm një anëtar i familjes së tyre është prekur nga virusi corona. Detyra themelore e komunës siç edhe ka qenë edhe këta muajt e fundit është që të mendojmë se si bashkë të ja dalim dhe të dalim faqebardhë në fund të kësaj pandemie me sa më pak pasoja në njerëzi dhe në ekonomi. Nuk është pandemia moment për të përfituar politikisht dhe poena politik. Kur është themeluar Shtabi Emergjent i Komunës, dhe vendimet e para kundër pandemisë, një prej problemeve më të mëdha që kemi hasur ka qenë paragjykimet e mëdha për këtë virus, paragjykimet

e para që është marre më u sëmure dhe njerëzit nuk kanë treguar që janë të prekur, mos identifikimi i emrave të të infektuarve, mos e përmend familjen time, mos e dërgo policinë e gjëra të ngjashme e deri tek bindja se virusi është gënjeshtër dhe se ata që po infektohen do marrin para por edhe ata që po vdesin familjet e tyre po marrin para dhe shteti do të marrë para në emër të tyre. Sot çfarë vendimi po duam ta marrim për do poena politike dëshirojmë ta bankrotojmë buxhetin e komunës duke e ushqyer pikërisht <postulatin më të rrezikshëm se ai i cili do të sëmuret do të përfitoj para>. Për këto vlerësime të cilat sot po i shpreh në kuvend e di që nuk janë popullsitë, sepse në fund të fund kuvendit është ai i cili po e merr atë vendim dhe ky nuk dëshiron që të imponoi sepse asnjëherë në jetën e tij nuk i ka imponuar asnjë vendim sepse të gjithë janë të lirë për të vendosur. Janë dy komuna deri më tani që kanë marrë vendime për ndarjen e nga 50 € për personat e prekur nga covid-19 Prishtina dhe Mitrovica, dhe ne sot e kemi rritur këtë shumë, pa e pasur një kosto financiare të këtij vendimi. Deri sot janë të infektuar rreth 1500 persona, dhe ky numër është dashur të merret për bazë dhe të bëhet kalkulimi se sa është kostoja financiare e këtij vendimi. Ai është për ti ndihmuar të gjithë, ashtu siç komuna i ka ndihmuar prej fillimit të pandemisë peronat e prekur, jemi prej komunave të vetme që kemi ofruar shërbime shëndetësore në shtëpi për të prekurit me covid-19 me shpenzime të komunës, i kemi pasur barnat esenciale me zero kosto për të prekurit. Nuk duhet harruar faktin se buxheti i komunës duhet të jetë i drejt sepse kemi me qindra rastet që vuajnë nga sëmundje të rënda dhe komuna nuk ka mjetet për ti ndihmuar. Ai kërkoi nga të gjithë që të ulen dhe të shohin mundësit se çfarë mund të bëjnë dhe propozoi që rastet sociale tu ndahen mjete, ose të bëhet një shumë lineare për të gjithë që është simbolike, por le ta dimë se me këtë vendim po ushqehet paragjykimi që e kemi pasur që nga fillimi i pandemisë e që është se do të marrin para ata që janë infektuar. Edhe një herë ai bëri thirrje që të gjendet një zgjidhje mes të gjitha grupeve politike ashtu që të merret një vendim lehtë i realizueshëm në praktikë. Lidhur me ndarjen e mjeteve financiare me këtë vendim mund të bëhen padrejtësi, për faktin se në qershor kur ka qenë piku i pandemisë nëse një anëtar i familjes ka dal pozitiv me virus, e tërë familja është testuar, ndërsa në shtator, kur kemi pasur mungesë testesh nëse një anëtar i një familje është dal pozitiv e gjithë familja me vendim është shpallur si pozitiv me virus edhe pse testi nuk iu është bërë dhe kjo krijon padrejtësi edhe në rastin e ndarjes eventuale të mjeteve financiare. Pastaj të gjithë përfituesit e subvencioneve duhet të bëhen publik dhe kjo detyrimisht i qetë në sipërfaqe edhe emrat e të infektuarve gjë kjo e cila është në kundërshtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe që bie ndesh me drejtat e njeriut. Ai kërkoi që të merret një pauzë që të konsultohen grupet kuvendar dhe qeveria dhe të gjendet një zgjidhje, pasi që propozimi i bërë nga grupi kuvendar i PDK-së nuk ka analizë financiare.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-tha se para se të merret ky vendim duhet të shikohet si është puna me buxhet. Tutje shtoi se kërkesa dhe propozimi i Partisë Demokratike është inkurajimi nga kryetari i komunës i cili del në rrejte sociale dhe deklaroi: se tash e tutej nuk do të ndërtohen asfalte por parat do të shkojnë në projekte tjera e beson që kryetari nuk e ka atë të dejtë pasi që kuvendi aprovon buxhetin e komunës. Pastaj ai ceku se është i mendimit që të ndihmohen rastet sociale, por edhe ato familje dhe individ që i kanë humbur vendet e punës nga pandemia e që janë shndërruar në raste sociale duhet të ndihmohen. Ai shprehu nevojën që të gjendet një zgjidhje, duke u shikuar ana financiare e elaboruar nga Drejtori i Financave dhe që vendimi i marr mos të jetë vendim popullsitë por një vendim i cili mund të realizohet në praktikë.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-tha se tendenca për dhënë konotacion tjetër propozimit të tyre është vërtet për keqardhje. Lidhur me koston financiare të vendimit sqaroi se ajo është studiuar mirë para se të merret kjo iniciativë, andaj në fondin 21 dhe 22 ka mjetet të lira dhe ato mund të zotohen deri më datën 24 dhjetor 2020. Ai kërkoi nga Drejtori i Financave që të deklarohet në

mënyrë të saktë për secilin pozicion ku kemi mjete të lira. Kostoja financiare e këtij vendimi mund të jetë deri në 300,000.00 € që nuk është shumë e madhe në relacion me buxhetin e komunës, kjo kosto financiare nuk është cekur në propozim për faktin se mund të kemi persona tjerë të infektuar. Sa i përket padrejtësive të përmendura këtu ato janë vetëm sa për të manipuluar për ti krijuar përfitime veti, por kjo gjë nuk mund të ndodh se askujt nuk mund ti krijohen përfitime, dhe se të gjitha rastet e regjistruar në IKSHPK është propozimi të përkrahen me mjete financiare. I vjen shumë keq që kryetari i komunën, para fillimit të mbledhjes tenton të ndikoj tek anëtarët e kuvend për të iu ndërruar mendimin, por ata duhet të jenë të lirë dhe plotësisht të pavarur në marrjen e vendimeve. Ai bënë të ditur se i ka informacionet e plota për keqpërdorimet që po ndodhin në komunë dhe shtoi se është e turpshme të thuhet se nuk ka pasur analizë financiare për këtë vendim.

**Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit**-tha se të gjithë e dëgjuam kryetarin e komunës duke e bërë moralistin, por të gjithë e dimë se ai nuk mund të bëj një gjë të tillë, pasi ai nuk mund ti shet moral anëtarëve të kuvendit. Ky nuk mundet që anëtarët e kuvendit ti paraqet si diçka që po veprojnë keq dhe po i shkaktojnë dëm komunës, duke tentuar të krijoj pasqyime të rrejshme për gjoja se po veprohet në kundërshtim me interesat e qytetarëve, këtë PDK nuk e ka bërë që tri vitet e saj në opozitë dhe nuk do ta bëjë kurrë. Personalisht ka biseduar me grupin e tij politik për të analizuar faktin se grup nuk ka bërë shumë politikë në kuvend, edhe për kundër faktit se kapaciteti i grupit është aq i madh për një gjë të tillë. Në rrafshin njerëzor grupi kuvendar i PDK-së ka thirrur një seancë të jashtëzakonshme për të gjetur modulim më të mirë për ti ndihmuar qytetarët, për të treguar se përfaqësuesit e tyre në kuvend janë të gatshëm tu dalin në ndihmë atyre që i kanë zgjedhur. Ai rikujtoj faktin se edhe kur ishte propozuar pakoja e parë e ndihmës financiare prej 100,000.00 €, ishte grup kuvendar i PDK-së që propozoi që ai të rritet në 200,000.00 € andaj grupi nuk ka bërë politikë në këto tri vite por ka shtri dorën e bashkëpunimit dhe ndihmës ndaj qeverisë komunale. Qeveria e komunës duhet të dal ti shpjegoj qytetarit, gjendjen e jo të merret me kalkulime politike ashtu siç vepron vazhdimisht kryetari i komunës, ju e dëgjuat se çfarë tha se ekziston paragjykimi se ata të cilët do të infektohen do të marrin para, këtë nuk e thotë një lider, për këto çështje ka pasur edhe protesta në shumë kryeqytete, por liderët e vërtet vazhdojnë tutje kur kanë bindjen se janë duke vepruar drejtë. Qytetarët janë të vetëdijshme për çështjen e pandemisë se gati secili qytetar ka pasur një familjar apo të afërt që ka kaluar shumë keq me virusin, gjendja ekonomike është rendura tej mase, ndërsa kryetari i komunës, ankohet për mungesë të kapaciteteve financiare. Ai ndjehet krenar për atë që nuk i ka votuar shumën financiare prej 140,000.00 € për hulumtimin e ekonomisë së Vushtrrisë, a ka pasur ndjenë e dhembjes kryetari, për parat e qytetarit të Vushtrrisë kur është bërë ai hulumtim, me procedurë të përsheptuar të negociimit, në këtë rast bëhet fjalë për besim për menaxhimin e parasë publike, sepse të gjithë e kemi parë se sa i besueshëm dhe sa vlen Xhafer Tahiri, i cili del dhe bën politikë dhe keqpërdor pandeminë për përfitim politikë. Ndarja e mjeteve nga Komuna e Prishtinës dhe Mitrovicës për të prekurit nga covid-19 është përkrahur gjerësisht nga qytetarët dhe kjo është parë edhe në reagimet në rrjetet sociale. Kryetari i komunës tonë jep një kompanie 140,000.00 € e që nuk dihet as për cilat arsye janë dhënë, dhe tani del dhe deklaron se nuk ka mjete të mjaftueshme, ai është për tu ulur për të diskutuar, por nuk është për ti lënë qytetarët në mëshirën e fatit dhe për këtë duhet të gjendet një zgjidhje. Sa i përket pagesës së inspektorëve, për të cilët po thuhet se nuk ka mjetet për ti paguar për punën shtesë, është gabim fatal i kryetarit të komunës, sepse punëtorët që kanë punua me ka 12 deri në 16 orë pune, më mirë ka qenë të kompensohen me ato mjete që u dhanë për studim të pandemisë, sepse edhe këto para që po iu japim qytetarëve do të kthehen në një formë në buxhet të shteti sepse rritet kërkesa agregate në shpenzim ekonomik të atyre familjeve. Nëse ka mjetet buxhetor dhe ato shkojnë në suficit atëherë më mirë është të ndihmohen qytetarët se sa ato mjete të shkojnë për komunat tjera.

Në fund ai tha se nga kjo seancë duhet të merret një vendim që qytetarëve u ofron ndihmë dhe që komuna iu zgjatë dorën e përkrahjes për qytetarët e vetë.

**Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së**-paraqiti sqarime lidhur me financat publike të Komunës së Vushtrrisë, duke njoftuar kuvendin se zotimet për mjetet financiare për këtë vit fiskal përfundojnë me 12 dhjetor të këtij viti, ndërsa pagesat mund të bëhen deri me 24 dhjetor të këtij viti. Sa i përket kategorisë së mallrave dhe shërbimeve është e vërtetë se ka mjete financiare në këtë kategori por se pagesat nuk mund të bëhen pasi që subvencionet janë kategori e ndarë. Sa i përket subvencioneve i kemi të lira rreth 354,000.00 € prej tyre 251, 000.00 € janë të ndara nga MAPL-ja të dedikuar ekskluzivisht për ndihmë për biznese dhe ato zotohen sot për këtë qëllim, pastaj tjerat i kemi për mbulimin e qirasë së banimit, dhe mbulimin e shpenzimeve për fëmijët e porsalindur, e që i bie se krejt këto mjete janë të planifikuara për tu shpenzuar.

**Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS-së**- paraqiti sqarime lidhur me numrin e të prekurve me covid-19 në Komunën e Vushtrrisë, ku deri tani të prekur nga ky virus janë 1475 persona, 1110 janë të shëruar, 40 persona kanë humbur jetën ndërsa 225 raste janë aktive sipas publikimit që ka bërë dje zëdhënësi i Ministrisë së Shëndetësisë. Si Drejtori e Shëndetësisë kemi zbatuar numër rekord të subvencioneve këtë vit, falë vendimit që ka marrë kuvendi për subvencionimin e fëmijëve të porsalindur deri më tani kemi ekzekutuar 722 rastet të subvencioneve për fëmijët e porsalindur, ndërsa janë në procedurë afër 100 raste të tjera që priten të subvencionohen këtë javë sepse jemi në fund e afati për ekzekutimit të pagesave me natyrë subvencion. Ndërsa si obligime për vitin e ardhshëm do të na barten të gjitha subvencionet për fëmijët e lindur nga data 12-31 dhjetor 2020, sepse përfundon afati i zotimit të mjeteve. Sa i përket pagesës së subvencioneve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve dihet mirëfilli se kjo pagesë ligjërisht është e ndaluar, dhe një gjë e tillë parqet shkelje ligjore. Si Drejtori e Shëndetësisë kemi obligimin e pagesës së qirave prej muajit korrik deri në muajin dhjetor për 20 familje me nga 600 € për secilën, në këtë kontekst maksimumi i subvencioneve që mund të mbesin të lira nga të hyrat vetanake janë 10,000.00 €, këto janë mundësit financiare të komunës, edhe pse nga prizmi shëndetësor të gjithë të sëmuret duhet të përkrahen porse mundësit janë të limituara. Ajo se çfarë është reale dhe që e ka thënë publikisht edhe herëve tjera është që qeveria e kaluar e lënë komunën me një stabilitet financiar, iu është falënderues të gjithë atyre që kanë punuar për ta ndërtuar një shëndetësi stabile dhe pa borxhe pavarësisht subjekteve politike që kanë udhëhequr Komunën e Vushtrrisë. Ne mund të marrim vendime të mira, por vendime të mira janë ato të cilat janë lehtë të zbatueshme, në këtë mbledhje mund të merret vendim për krijimin e obligimeve prej 300,000.00 € në fushën e subvencioneve, por vetëm sa do të krijojmë obligime për komunën por ai vendim nuk do të mund të zbatohet. Andaj apeloj që të ruhet tradita që ka krijuar Komuna e Vushtrrisë me vite për ruajtjen e stabilitetit financiar duke mos hyrë në obligime të cilat nuk do të mund ti zbatojmë. Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve është mundësia që të aprovohen pako shëndetësore që tash e tutej të gjitha rastet e infektuara me covid-19 tu mbulohej terapia. Kjo pako do të mund të realizohej përmes një kontrate nga aktiviteti i prokurimit duke përzgjedhur një operator farmaceutik. Në fund apeloj të kemi një vendim racional dhe të zbatueshëm, duke ruajtur qëndrueshmërinë financiare të komunës, kjo edhe për faktin se financat e komunës janë të pamjaftueshme, për përkrahjen e të gjithëve e sidomos peronat që vuajnë nga sëmundje të rënda që janë pakrahasimishtë më të kushtueshme financiarisht se sa virusi covid -19.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-tha se sa i përket akuzave të cila i ka në menynë e vet anëtari i kuvendit Lorik Maxhuni, tha se i vjen keq për të, por kjo është pjesë e edukatës së tij. Tutje shtoi se që nga fillimi i pandemisë jemi komuna që kemi ndarë 250,000.00 € për bizneset shumë kjo e cila që nga nesër do të filloj të distribuohet, kjo do ti dedikohet bizneseve dhe mikro-bizneseve,

kjo për ta mbajtur shëndetshëm ekonomin dhe për mos të humbur vende pune, kjo shumë për biznes do të jetë prej 300-1500 €. Pastaj me qëllim të zbutjes së efekteve të pandemisë të gjithë artistët e komunës do të subvencionohen, janë dyfishua bursat për studentet në këtë vit, është paguar transporti për në shkollë për çdo fëmijë me nevoja të veçanta, kjo politikë është zbatuar përherë të parë në Komunën e Vushtrrisë, ndërsa sa i përket mjeteve për studim të fizibilitetit për efektet e pandemisë, që është vendim i kuvendit, njoftoj se do të jemi komuna e parë në Kosovës që do të kemi plan për rimëkëmbje ekonomike, dhe ai plan do të vjen për diskutim në kuvend dhe kuvendi do të vendos se a do të shkojmë me atë plan. Pastaj ai pranon faktin se është kryetari i vetëm i komunës në Republikën e Kosovës, që për katër vitet e ardhshme investimi në asfalt të jetë zero, dhe këtë vendim ai do të ia sjellë kuvendit që buxheti i komunës për vitet 2022-2026 të jetë me investim zero në asfalt nga buxheti i komunës, por kjo nuk do të thotë se ne nuk do të shtrojmë asfalt, dhe këtë do ta vendos kuvendi por një propozim-vendim të tillë ai do ta sjellë para kuvendit. Nga zëvendësimi i këtyre projekteve nga asfalti në projekte zhvillimore siç është p.sh investim në masën aktive të punësimit ku do ti kemi 800,000.00 € në vit, ku do ti kemi deri në 500 të ri që do ti fusim në tregun e punës me pagesë me praktikë, do ti kemi 500,000.00 € deri 6,000.000 € që do të blejmë kredi për bizneset por kjo do të vijë këtu në kuvend dhe do ta diskutojmë. Sa i përket menaxhimit të pandemisë, ai shpërfaqi anët pozitive që menaxhmenti i komunës së Vushtrrisë i ka pasur në krahasim me komunat tjera, p.sh Komuna e Vushtrrisë ka shpenzuar vetëm 20,000.00 € për dezinfektimin e objekteve, ndërsa komunat tjera kanë shpenzuar deri në 400,000.00 € për këtë proces. Në fund përsërit se plani i rimëkëmbjes ekonomike më së largu do të vjen në kuvend në muajin dhjetor, ku do të parashihen të gjitha instrumentet, mekanizmat dhe burimet e financimit të rimëkëmbjes ekonomike të Komunës së Vushtrrisë, ndarja e mjeteve për këtë qëllim është vendim i kuvendit. Lidhur me akuzat edhe njëherë ceku se duhet ditur se kush po fletë për moral, pasi gjithkujt i tregon puna e tij, edukata familjare dhe besimi i dhënë pasi 15,000.00 € qytetar e kanë votuar për ta hequr nga pushtetit për dhjetë vitet e ardhshme për atë moral të cilin e përfaqëson anëtari i kuvendit Lorik Maxhuni.

**Nasuf Aliu, kryesues i Kuvendit**-në rekapitullimin e debatit lidhur me propozim-vendimin për përkrahje financiare për të prekurit me covid-19, në konsultim me të gjitha grupet politike në kuvend konstatoj me sa vijon: që vendimi të ketë efekt retroaktiv, ky vendim të përkrah familjet me asistencë sociale, familjet me të ardhur të ulëta, dhe kushte të rënda ekonomike në shumë prej 150-300 €, të mbështeten familjet që kanë të ardhur më pak se 350 € për muaj, të gjithë përfituesit do të arrij të përfitojnë përmes aplikimit dhe respektimit të procedurave ligjore dhe konfom rregullores për subvencionet e aprovuar nga kuvendit i komunës si dhe të formohet një komision prej 5 anëtarëve nga ana e kuvendi i cili do të vendos për përfituesit e këtyre subvencioneve. Aplikimi duhet të bëhet në formë online

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-sqaroi** se tek rastet e vdekjeve, është problematike, sepse në radhë të parë nuk lejohet pagesa e subvencioneve për familjet të cilat kanë humbur anëtarët e tyre, por këto rastet komisioni mund ti përfshij tek familjet e prekura nga covid-19.

***Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:***

**1. Me këtë vendim ofrohet përkrahja financiare për familjet e prekura nga pandemia Covid-19 të cilat janë përfituese të asistencës sociale, familjeve me gjendje të rëndë ekonomiko-sociale në shumë financiare prej njëqind e pesëdhjetë euro (150 €) deri në treqind euro (300**

€), përkrahën familjet që nuk kanë të ardhura, ato me të ardhura më pak se treqind e pesëdhjetë euro (350 €) në muaj në Komunën e Vushtrrisë.

2. Përfituesit e këtyre mjeteve financiare, mund të aplikojnë përmes formave online, apo në formë fizike në Komunën e Vushtrrisë nga data 05 janar 2021, konform dispozitave ligjore të përcaktuar me Rregulloren (KKV) Nr. 01/2018 për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridike – OJQ dhe Ndhimë Momentale Personave Fizikë.

3. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi do të sigurohen nga kategoria e subvencioneve në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa si dhe Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

5. Ky vendim do të ketë efekt retroaktiv nga muaji mars 2020, dhe fillon të prodhojë efekt juridik nga data 05 janar 2021.

6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-në emër të grupit kuvendar të PDK-së propozoi Basri Menxhiqin për anëtar të komisionit.

**Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit**-nga radhët e LVV-së propozoi Faton Shabnin për anëtar të komisionit.

**Arta Ymeri, anëtare e kuvendit**-propozoi Ismet Hajrizin për anëtar të komisionit nga radhët e LDK-së.

**Nasuf Aliu, kryesues i Kuvendit**-propozoi Abdullah Vojvoden për anëtar të komisionit nga radhët e NISMA Socialdemokrate.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-propozoi Sdiqe Bajgoren për anëtare të komisionit nga radhët e LB-së.

**Sajdie Bajgora, anëtare e kuvendit**-njoftoi se për shkak të obligimeve tërhiqet nga ky komision dhe propozon Nezir Klinakun për anëtar komisioni nga radhët e LB-së.

**Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit**-tha se me qëllim të respektimit të barazisë gjinore, grupi kuvendar i LVV-së në vend të Faton Shabanit, propozon Gresa Mulin për anëtare të komisionit.

**Pas dhënies së propozimeve për anëtarët e komisionit kuvendar, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim themelohet komisioni kuvendar për vlerësimin e gjendjes dhe shqyrtimin e aplikacioneve për familjet e prekura nga pandemia covid-19, të cilat janë përfituese të asistencës sociale, familjeve me gjendje të rëndë ekonomiko-sociale, familjet që nuk kanë të ardhura, ato me të ardhura më pak se treqind e pesëdhjetë euro (350 €) në muaj në Komunën e Vushtrrisë.

2. Përbërja e komisionit të lartë cekur është si në vijim:

- 2.1 Basri Menxhiqi, anëtar i komisionit;
- 2.2 Ismet Hajrizi, anëtar i komisionit;
- 2.3 Gresa Muli, anëtare e komisionit;
- 2.4 Nezir Klinaku, anëtar i komisionit;
- 2.5 Abdullah Vojvoda, anëtar i komisionit.


3. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të ketë për detyrë t'i vlerësojë dhe analizojë të gjitha aplikacionet, të vlerësojë gjendjen e familjeve që janë të prekura me pandeminë covid-19 dhe në bashkëpunim me komisionin për shëndetësi do të vendos për përfituesit e subvencioneve.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: komisioni i cekur në pikën 2 të këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës së Vushtrrisë.

**Mbledhja përfundoi në ora 12:10.**

**Bastri Duraku**  
  
Procesmbajtës

**Nasuf Aliu**  
  
Kryesues i Kuvendit

